



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr.59, Datë 25.02.2021

MBI

**MIRATIMIN E LICENCËS TIP PËR VEPRIMTARINË E OPERIMIT NË HAPËSIRAT
E DEPOZITIMIT TË GAZIT NATYROR.**

Në mbështetje të nenit 16, të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar, nenit 22 dhe nenit 23, të Ligjit nr. 102/2015, “Për Sektorin e Gazit Natyror”, i ndryshuar, si dhe nenit 15 dhe 26, të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, 17.06.2016; bordi i ERE, në mbledhjen e tij të datës 25.02.2021, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 30/10 prot., datë 23.02.2021 të përgatitur nga Drejtoritë Teknike, mbi miratimin e licencës TIP për veprimtarinë e operimit në hapësirat e depozitimit të gazit natyror,

Konstatoi:

- Me vendimin nr. 193, datë 20.11.2020, bordi i ERE ka filluar procedurën për miratimin e Licencës TIP për veprimtarinë e operimit në hapësirat e depozitimit të gazit natyror.
- Me shkresën nr. 62/39 prot., datë 27.11.2020, ERE ka vijuar me publikimin në media të njoftimit për fillimin e procedurës për miratimin e licencës TIP për veprimtarinë e operimit në hapësirat e depozitimit të gazit natyror, duke ftuar palët e interesit të shprehin komentet apo sugjerimet mbi këtë draft.
- Me shkresën nr. 1224 prot., datë 27.11.2020, janë kërkuar komente dhe opinione nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Autoriteti i Konkurrencës, shoqëritë “Albgaz” sh.a., “Albpetrol” sh.a., “Tap AG Albania” sh.p.k., “Anio Oil&Gas” sh.p.k., “Phoenix Petroleum” sh.a., “C.G.C” sh.p.k. dhe “Balkgaz” sh.p.k.
- Në përgjigje të kërkesës për komente dhe opinione është shprehur Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, e cila parimisht është dakord që bordi i ERE-s të ndjekë procedurën për miratimin e licencës TIP për veprimtarinë e operimit në hapësirat e depozitimit të gazit natyror.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Të miratojë licencën TIP për veprimtarinë e operimit në hapësirat e depozitimit të gazit natyror.
2. Drejtoria e Gazit Natyror të njoftojë të interesuarit për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE
Petrit AHMETI